



**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 113 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 14.10.2024, nxjerr këtë:

### **V E N D I M**

#### **Për Miratimin e Buxhetit sipas Qarkores 2025/2, Qarkorja Finale dhe Kufijtë Buxhetor**

- I. Miratohet e buxheti sipas Qarkores 2025/2, qarkorja finale dhe kufijtë buxhetor.
- II. Buxheti si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Prishtinë, 14.10.2024





**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

## Plani i Buxhetit i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027

Tetor, 2024

## Përkufizimet

KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
SKQZ	Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
LMFPP	Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
BK	Buxheti i Kosovës
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës
KKZ	Komisioni Komunal i Zgjedhjeve
QNR	Qendra e Numërimit dhe Rezultateve
QV	Qendra e Votimit
VV	Vend Votimi
KVV	Këshillat e Vend Votimit
€	Euro

## PËRMAJTJA

Plani i Buxhetit i Komisionit Qendror te Zgjedhjeve për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027 .....	1
Përkufizimet .....	2
HYRJE.....	4
1. PLANI I BUXHETIT 2025-2027 .....	5
1.1 Plani i Buxhetit për vitin 2025 .....	6
1.2 Plani i Buxhetit ne Programin e Sekretariatit për vitin 2025 .....	7
1.2.1 Paga dhe Mëditje .....	8
1.2.2 Mallra dhe Shërbime.....	8
1.2.3 Shpenzimet Komunale .....	8
1.2.4 Shpenzimet Kapitale .....	9
1.3 Plani i Buxhetit ne Programin e Zgjedhjeve për vitin 2025.....	9
1.3.1 Mallra dhe Shërbime.....	9
1.3.2 Shpenzimet Komunale .....	10ë2.
Vlerësimi i Buxhetit për vitin 2026.....	11
2.1 Vlerësimi i Buxhetit në Programin e Sekretariatit për vitin 2026 .....	11
2.2 Vlerësimi i Buxhetit në Programin e Zgjedhjeve për vitin 2026.....	11
2.3 Vlerësimi i Buxhetit në Programin për Mbështetje Demokratike për vitin 2026 .....	11
3. Vlerësimi i Buxhetit për vitin 2027 .....	12
3.1 Vlerësimi i Buxhetit në Programin e Sekretariatit për vitin 2027 .....	12
3.2 Vlerësimi i Buxhetit në Programin e Zgjedhjeve për vitin 2027.....	12
3.3 Vlerësimi i Buxhetit në Programin për Mbështetje Demokratike për vitin 2027 .....	12

## Lista e Tabelave

Tabela 1. Buxheti i KQZ-së dhe kufijtë buxhetor për vitin 2025.....	7
Tabela 2. Buxheti në programin e Sekretariatit dhe kufijtë buxhetor për vitin 2025 .....	8
Tabela 3. Buxheti në programin e Zgjedhjeve dhe kufijtë buxhetor për vitin 2025.....	9
Tabela 4. Buxheti në programin Mbështetje Demokratike dhe kufijtë buxhetor për vitin 2025	11



## HYRJE

Pas aprovimit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të KQZ-së për vitet 2025-2027, nga të gjitha njësitë në Sekretariat është kërkuar që të përgatisin kërkesat e tyre buxhetore për Planin e Buxhetit 2025-2027.

Sipas përgjegjësi të përcaktuara në nenin 20 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve është e obliguar të nxjerr Qarkoren Buxhetore më të cilën sigurohen informata dhe udhëzime mbi përkufizimet dhe tavanet e shpenzimeve për organizatën përkatëse buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal dhe vlerësimet jo të detyrueshme për dy vitet e ardhshme fiskale.

Qarkorja buxhetore përfshinë: procedurat që duhet të përdoren gjatë përgatitjes së propozim-buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore, informatat që duhet të parashtrihen në propozim-buxhet, futjen e të dhënave në SZHMB dhe PIP, datën deri kur duhet të përfundohet dhe dorëzohet në Ministri propozim-buxhetin dhe kërkesa për ndarje buxhetore.

Ministri e Financave, Punës dhe Transfereve ka lëshuar Qarkoren buxhetore 2025/02, ku ofron kufijt final buxhetor për vitin 2025 dhe projeksionet buxhetore 2026-2027, si dhe janë dhënë informata të mjaftuara për hartimin e propozim buxhetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duke u bazuar në udhëzimet e dhëna në Qarkoren 2025/02 ka përgatitur propozim Buxhetin për periudhën 2025-2027. Përgatitjes dhe hartimit të këtij dokumenti i ka parapri përcaktimi i objektivave të institucionit, identifikimi i nevojave dhe analiza e kërkesave nga secila njësi kërkuese në organizatën tonë.

Meqenëse në vitin 2025 planifikohen të mbahen zgjedhje, fokusi është përqendruar në buxhetin për organizim të Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës dhe Zgjedhjet Komunale në gjithë vendin. Po ashtu është planifikuar buxhet operacional dhe në ngritjen e kapaciteteve, fuqizimin institucional, avancimin e stafit për planifikimin, organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve ashtu si e parashih edhe legjislacioni në fuqi.

Plani i buxhetit i KQZ-së është strukturuar në atë mënyrë ku në pjesën e parë të këtij dokumenti është paraqitur propozim buxheti i KQZ-së 2025-2027 dhe pastaj është vazhduar me propozim-buxhetin sipas viteve, programeve dhe kategorive ekonomike. Të gjitha vlerat buxhetore janë paraqitur në valutë-Euro.

Si përfundim, ky dokument përmban kërkesat buxhetore në funksion të përmbushjes së nevojave dhe obligimeve të shpenzimeve organizim e dy proceseve Zgjedhore, kërkesave për avancim në organizim, administrim sa më cilësor të proceseve zgjedhore.

## 1. PLANI I BUXHETIT 2025-2027

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është Institucion i pavarur kushtetues i themeluar në bazë të kapitullit të VII të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Misioni i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është përcaktuar të organizojë zgjedhje kredibile dhe me standarde të larta, duke u ofruar të gjithë qytetarëve mundësi dhe shërbime cilësore zgjedhore për ushtrimin e së drejtës së tyre për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Vizioni i KQZ-së është për një institucion të qëndrueshëm dhe inovativ, që forcon demokracinë përmes zgjedhjeve, të cilat gëzojnë besimin e qytetarëve dhe të akterëve tjerë. Me qëllim të përmbushjes së misionit dhe vizionit, në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet, Planin e Punës dhe analizës së shpenzimeve të realizuara në procese zgjedhore dhe jo zgjedhore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve sipas udhëzimeve dhe instruksioneve të dhëna nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka përgatitur Planin e buxhetit për vitet 2025-2027.

Bazë për hartimin e Planit të buxhetit për vitet 2025-2027 ka shërbyer Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2025-2027 dhe janë harmonizuar kërkesat e njësive me obligimet të cilat rrjedhin nga Ligji Nr. 08/L- 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe Ligji Nr. 08/L-122 për Financimin e Subjekteve Politike.

Hartimi i Planit të buxhetit 2025-2027 është mbështetur në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të KQZ-së për vitet 2025-2027

Gjithashtu analiza e shpenzimeve të realizuara operacionale dhe zgjedhore për zgjedhjet parlamentare dhe lokale të mbajtura viteve të fundit, ka shërbyer si bazë për hartimin e buxhetit për vitin 2025 si dhe për vlerësimet buxhetore për vitet 2026-2027.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në planifikimin e buxhetit për vitet në vazhdim është fokusuar në zbatimin e objektivave dhe adresimin e çështjeve që janë ndërlidhur me përgatitjet për procesin zgjedhor, dhe zhvillimin e aktiviteteve të rregullta mbështetëse.

Në rast se paraqitet nevoja për Zgjedhje të Jashtëzakonshme atëherë KQZ-ja sipas legjislacionit i drejtohet me kërkesë për buxhet shtesë Qeverisë e cila përmes mekanizmave duhet të i sigurojë mjetet për mbajtjen e zgjedhjeve.

Duke pasur parasysh Ligjin mbi Zgjedhjet dhe faktin se në vitin 2021 u mbajtën zgjedhjet parlamentare dhe Zgjedhjet Lokale.

Prandaj i tërë fokusi është përqendruar për krijimin e kushteve dhe organizimin e proceseve zgjedhore sa më të mira, të drejta dhe transparente të cilat planifikohen të mbahen në vitin 2025.

Bazë e planifikimit të buxhetit për procese zgjedhore kanë shërbyer në radhë të parë analizat, raportet dhe informatat mbi shpenzimin e buxhetit nga zgjedhjet e fundit të mbajtura në vitin 2021, vlerësimi për shpenzimet e materialit zgjedhor sensitiv dhe jo sensitiv, numri i votuesve, angazhimi i trupave zgjedhore, numri i qendrave të votimi dhe vendvotimet, angazhimi i



trajnerëve, stafit i përkohshëm dhe një varg shpenzimesh tjera operative për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve.

Buxheti i KQZ-së është planifikuar për tri programet:

- ✓ 14100 - Programi i Sekretariatit në të cilin janë përfshirë shpenzimet operationale ;
- ✓ 14200 - Programi i Zgjedhjeve është planifikuar buxheti për zhvillimin e aktiviteteve të rregullta për përgatitjen e proceseve zgjedhore dhe
- ✓ 10400 - Mbështetja e Partive Politike – subvencionet përmes të cilave mbështeten aktivitetet e subjekteve politike.

Në buxhetin e Zgjedhjeve të KQZ-së për periudhën tri vjeçare 2025-2027, janë planifikuar disa projekte të cilat do të ndikojnë në rritjen e pjesëmarrësve të rijë dhe femrave në procese zgjedhore në identifikimin elektronik të votuesve dhe në ngritjen e kapaciteteve të stafit nëpërmjet trajnimeve dhe vizitave studimore si dhe është planifikuar buxheti për zgjedhjet parlamentare dhe zgjedhjet lokale.

Duke vlerësuar se zgjedhjet parlamentare do të mbahen me 9 shkurt në fillim të vitit 2025, disa prej aktiviteteve si për furnizime, shërbime dhe trupa zgjedhore është planifikuar të zhvillohen në gjysmën e dytë të vitit 2024. Kështu që një pjesë e buxhetit zgjedhor është planifikuar të realizohet në vitin 2024.

Ndërkaq në buxhetin Mbështetja e Partive Politike në pajtim me Ligjin për financimin e subjekteve politike janë planifikuar subvencionet përmes të cilave mbështeten aktivitetet e subjekteve politike.

### 1.1 Plani i Buxhetit për vitin 2025

Pas pranimit të Qarkores së parë buxhetore 2025/02 dhe me qëllim të harmonizimit me kufijtë e lëshuar buxhetor, KQZ-ja, ka vlerësuar kërkesat buxhetore të njëjësive kërkuese dërguar pas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve. Mirëpo ishte e pa mundur të bëhet harmonizimi i buxhetit sipas kufijve të lëshuar në Qarkoren 2025/02.

Në vitin 2025 janë të planifikuara mbajtja e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës dhe Zgjedhjet Lokale- për asamble komunale dhe kryetar të komunave. Sipas Ligjit për Zgjedhjet lokale këto zgjedhje planifikohet të mbahen në dy raunde dhe kostoja e tyre është më e lartë se e zgjedhjeve parlamentare.

Prandaj sipas vlerësimeve dhe planifikimeve të bëra për këto zgjedhje si dhe për shpenzimet e tjera rrjedhëse të KQZ-së, buxheti i planifikuar në vitin 2025 është në vlerë prej 23,239,332 euro. Kështu që buxheti i KQZ-së është më i lartë në dy kategoritë ekonomike siç janë: Paga dhe mëditje buxheti është me i larte prej 257,082.00 dhe për 15 pozita më shumë se kufijtë e caktuar

buxhetor me Qarkoren 2025/02. Në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime – buxheti është me i lartë prej 654,614.69 euro.

Ne total propozim buxheti është më i lartë për 911,697.00 euro se kufijtë buxhetor në Qarkoren 2025/02.

Në tabelë është paraqitur buxheti i planifikuar i KQZ-së dhe buxheti sipas Qarkores 2025/02.

Kategoritë ekonomike	Buxheti i planifikuar i KQZ-së për vitin 2025	Buxheti sipas Qarkores 2025/02	Ndryshimi ne mes Planit dhe Qarkores
Të punësuarit	108	93	15
Paga dhe mëditje	1,493,618.88	1,236,537.00	257,081.88
Mallra dhe shërbime	16,403,612.69	15,748,998.00	654,614.69
Shpenzime Komunale	28,100.00	28,100.00	-
Subvencione dhe transfere	4,800,000.00	4,800,000.00	-
Shpenzime kapitale	514,000.00	514,000.00	-
Gjithsejtë	23,239,331.57	22,327,635.00	911,696.57

*Tabela 1. Buxheti i KQZ-së dhe kufijtë buxhetor për vitin 2025*

Buxheti i planifikuar për vitin 2025 është në shumë prej 23,239,332 euro, përmban buxhetin e tri programeve: Në Programin e Sekretariatit është planifikuar buxheti për shpenzimet në funksionim të institucionit, ne programin e Zgjedhjeve është planifikuar buxheti për shpenzimet e aktiviteteve ne Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe Zgjedhjet Lokale dhe në programin Fondi për mbështetje demokratike është planifikuar buxheti për subvencionim të Subjekteve Politike të cilat janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës.

## 1.2 Plani i Buxhetit në Programin e Sekretariatit për vitin 2025

Kërkesat buxhetore në vitin 2025 të planifikuara në programin e Sekretariatit janë në shumë prej 2,418,481.88 euro. Në këtë program planifikimi i buxhetit bëhet kryesisht për mbulimin e aktiviteteve për funksionim të organizatës.

Kategoritë ekonomike	Buxheti në programin e Sekretariatit	Buxheti sipas Qarkores 2025/02	Ndryshimi në mes Planit dhe Qarkores
Të punësuarit	108	93	15
Paga dhe mëditje	1,493,618.88	1,236,537.00	257,081.88
Mallra dhe shërbime	740,763.00	616,463.00	124,300.00
Shpenzime Komunale	23,600.00	23,600.00	-
Shpenzime kapitale	161,000.00	161,000.00	-
Gjithsejtë	<b>2,418,981.88</b>	<b>2,037,600.00</b>	<b>381,381.88</b>



*Tabela 2. Buxheti ne programin e Sekretariatit dhe kufijtë buxhetor për vitin 2025*

### 1.2.1 Paga dhe Mëditje

Në këtë program është planifikuar buxheti për paga dhe mëditje i cili është më i lartë se buxheti i dhënë në kufij buxhetor edhe për numrin e të punësuarave është me i larte pre 15 zyrtare, po ashtu edhe në shumën e mjeteve prej 257,081.88 euro.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ne funksion te zbatimit te Ligjit Nr. 08/L-197 Për Zyrtarët Publik, Ligji Nr. 08/L- 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe Ligji Nr. 08/L-122 për Financimin e Subjekteve Politike. KQZ ka miratuar rregulloret e brendshme: Rregulloren me nr. 06/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike dhe Rregulloren me nr. 07/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Gradat dhe koeficientet për pozitat e reja te krijuara sipas legjislacionit te ri te KQZ-së janë ne harmoni Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

### 1.2.2 Mallra dhe Shërbime

Planifikim i buxhetit në mallra dhe shërbime është në shumë prej 124,300.00 euro, planifikimet në këtë kategori bëhen kryesisht për kryerjen e aktiviteteve për funksionimin e Organizatës siç janë: shpenzimet për organizimin e punëtorive të cilat kanë të bëjnë me mësimet e nxëna të dalura nga aktivitetet e organizimit të zgjedhjeve, hartimin e planit të punës të KQZ-se, Hartimin e raporteve vjetore të KQZ-së, pjesëmarrjen në vëzhgimin e zgjedhjeve në vendet e ndryshme të botës, pjesëmarrje në punëtorit tjera me qellim të shkëmbimit të përvojave të punës, shpenzimet në emër të përfaqësimit, shpenzimet për anëtarësimet në Organizata ndërkombëtare, shpenzimet e telekomunikimit, shpenzime për furnizime me material zyrtar, organizime të takimeve në javën e zgjedhjeve, auditimet e raporteve vjetore financiare të subjekteve politike si dhe raporteve për deklarimet financiare të fushatave dhe trajnime të përfaqësuesve financiar të partive politike.

### 1.2.3 Shpenzimet Komunale

Në kategorinë ekonomike shpenzimet komunale është planifikuar buxhet në shumë prej 23,600.00 këto shpenzime kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet e Energjisë elektrike për objektet te cilat KQZ i ka në menaxhim siç janë Depoja qendrore me lokacion në Fushë Kosovë, për disa nga zyrtar e Zyrtareve Ekzekutiv Komunal te Zgjedhjeve. Shpenzimet për telefoninë fikse, shpenzimet për ujë dhe mbeturina.

#### 1.2.4 Shpenzimet Kapitale

Në kategorinë e shpenzimeve kapitale janë në shumë prej 161,000.00 euro dhe janë të planifikuara për tri (3) projekte kapitale siç janë: Vazhdimi i projektit për renovim të anexit të Objektivit të KQZ. Ky projekt ka vlerën totale prej 150,000.00 euro dhe është i ndarë në dy vite, pjesa e parë është buxhetuar në vitin 2024 dhe cila ka vlerën prej 54,500.00 euro dhe pjesa e dytë në vitin 2025 e cila ka shumën 95,500.00 euro. Blerja e veturës zyrtare në shume prej 35,500.00 euro për nevoja të Zyrës për Regjistrim Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike dhe Softveri për menaxhimin e buxhetit dhe financave që ka shumën prej 30,000.00 euro.

Me këtë qarkore buxhetore KQZ-së janë ndarë mjete në kategorinë e shpenzimeve kapitale, në programin e Sekretariatit në kategorinë e shpenzimeve kapitale është në shumë prej 161,000.00 euro.

#### 1.3 Plani i Buxhetit në Programin e Zgjedhjeve për vitin 2025

Kërkesa buxhetore të planifikuara në programin e zgjedhjeve për vitin 2025 janë si nevojë për realizimin e aktiviteteve për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe Zgjedhjet Lokale, që parashihet të mbahen në pjesën e dytë të vitit. Buxheti total i vlerësuar është në vlerë prej 15,600,849.69 euro

Planifikimi i buxhetit në programin e Zgjedhjeve është bazuar në obligimet ligjore që burojnë nga Ligji Nr. 08/L- 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Planifikimeve për implementimin planit të aktiviteteve të planifikuara nga KQZ-ja

Kategoritë ekonomike	Buxheti në programin e Zgjedhjeve	Buxheti sipas Qarkores 2025/02	Ndryshimi në mes Planit dhe Qarkores
Mallra dhe shërbime	15,662,849.69	15,132,535.00	530,314.69
Shpenzime Komunale	4,500.00	4,500.00	-
Shpenzime kapitale	353,000.00	353,000.00	-
<b>Gjithsejtë</b>	<b>16,020,349.69</b>	<b>15,490,035.00</b>	<b>530,314.69</b>

Tabela 3. Buxheti në programin e Zgjedhjeve dhe kufijtë buxhetor për vitin 2025

##### 1.3.1 Mallra dhe Shërbime

Në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime në programin e Zgjedhjeve është i planifikuar buxhet në shumë prej 16,020,349.69 euro, ky buxhet ka të bëjë për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe Zgjedhjet Lokale. Buxheti për zgjedhjet Lokale është i planifikuar edhe për raundin e dytë për kandidatet për kryetar komuna për ato komuna të cilat do të shkojnë në balotazh.



Buxhetin më të madh të kësaj kategorie e marrin Stafi i cili angazhohet në ditën e zgjedhjeve (KVV-të), Anëtarët e KKZ-ve, Trajnerët e KVV-ve, Stafi ditor i Qendrave të Numërimit dhe Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve, Stafi i përkohshëm i cili angazhohet në KQZ. Po ashtu në këtë kategori planifikohen të gjitha materialet tjera si janë Furnizime me Fletëvotime, broshura, informim publik, shpenzime të telekomunikimit, shpenzimet për dërgesa postare brenda dhe jashtë vendi, shpenzimet për udhëtime jashtë vendin me qëllim të vëzhgimit të procesit të prodhimit të fletëvotimeve, furnizime me pakot e vendvotimeve, furnizime me forma zgjedhore, transporti i materialit senzitiv dhe josenzitiv, furnizim me harduer, furnizim me ID për gjithë personelin e angazhuar në procesin e zgjedhjeve duke i përfshirë dhe vëzhguesit.

Diferenca në mes të planifikimeve buxhetore të KQZ-së dhe qarkores buxhetore 2025/02 është në shumë prej 530,314.69 euro

### 1.3.2 Shpenzimet Komunale

Në kategorinë ekonomike shpenzimet komunale është planifikuar buxhet në shumë prej 4,500.00 euro këto shpenzime kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet e Energjisë elektrike për objektet të cilat KQZ planifikon të i marr me qira dhe për të cilat do të krijohen shpenzime për Energjinë elektrike, mbeturina dhe ujë. Po ashtu është planifikuar buxhet për shpenzime të telefonisë fikse për aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve.

### 1.3.3 Shpenzimet Kapitale

Në kategorinë e shpenzimeve kapitale janë në shume prej 353,000.00 euro dhe janë të planifikuara për tri (3) projekte kapitale siç janë: Detektor, dyer skaner (metaliqe) për kontrollim të stafit të QNR (Walk Through Metal Detectors For Security) 3,600.00 euro. Blerja e veturave zyrtare në shumë prej 99,400.00 euro për nevojat të Sekretariatit të KQZ-së dhe Zbatimi i pilot i projektit për Identifikimin Elektronik të Votuesve për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës që ka shumën prej 250,000.00 euro.

Me këtë qarkore buxhetore KQZ-së janë ndare mjete në kategorinë e shpenzimeve kapitale, në programin e Zgjedhjeve në kategorinë e shpenzimeve kapitale është në shumë prej 353,000.00 euro.

## 1.4 Plani i Buxhetit në Programin për Mbështetje Demokratike për vitin 2025

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në Ligjin Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058, Ligjin Nr. 04/L-122 dhe LIGJI NR. 08/L-122 dhe bazuar me Ligjin për Ndarjet Buxhetore vjetore. KQZ, Subvencionon Subjektet Politike sipas numrit të deputeteve të certifikuar nga rezultati i Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës. Mjetet buxhetore të planifikuara për këtë kategori janë në shumë prej 4.8 milion euro.



Kategoritë ekonomike	Buxheti ne programin Mbështetje Demokratike	Buxheti sipas Qarkores 2025/02	Ndryshimi ne mes Planit dhe Qarkores
Subvencione dhe transfere	4,800,000.00	4,800,000.00	-
Gjithsejtë	<b>4,800,000.00</b>	<b>4,800,000.00</b>	-

Tabela 4. Buxheti ne programin Mbështetje Demokratike dhe kufijtë buxhetor për vitin 2025

Ne këtë kategori nuk ka ndryshim të shumës në mes të planifikimit dhe ndarje së mjeteve sipas qarkorës 2025/02.

## 2. Vlerësimi i Buxhetit për vitin 2026

Vlerësimet e buxhetit për vitin 2026 janë më të ulëta se në vitin paraprak sepse planifikimet kryesisht kanë të bëjnë me shpenzimet operacionale, për përkrahje dhe avancim të proceseve zgjedhore si tërësi si dhe buxheti për mbështetje të partive politike.

Buxheti i vlerësuar për pri programet është në vlere prej 7,860,606.88 euro nga i cili për paga dhe mëditje 1,382,618.88 euro, mallra dhe shërbime 820,368.00, shpenzime komunale 16,600.00 dhe subvencione e transfere 5,641,020.00 euro.

### 2.1 Vlerësimi i Buxhetit ne Programin e Sekretariatit për vitin 2026

Në Sekretariat Buxheti i planifikuar për vitin 2026 është 2,204,586.88 euro nga të cilat në paga dhe mëditje janë planifikuar 1,382,618.88 euro për 108 zyrtarë, në mallra dhe shërbime 805,368.00 euro, në shpenzime komunale 16,600.00 euro.

### 2.2 Vlerësimi i Buxhetit ne Programin e Zgjedhjeve për vitin 2026

Në programin e Zgjedhjeve, në vitin 2026 i cili vlerësohet si vit jo zgjedhor, planifikohet buxheti të arrij vlerën prej 15,000.00 euro, ky buxhet është i planifikuar ne kategorinë e ekonomike mallra dhe shërbim për furnizim me lidhëse për kutitë e votimit.

### 2.3 Vlerësimi i Buxhetit ne Programin për Mbështetje Demokratike për vitin 2026

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar ne Ligjin Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058, Ligjin Nr. 04/L-122 dhe LIGJI NR. 08/L-122 dhe bazuar me Ligjin për Ndarjet Buxhetore vjetore. KQZ, Subvencionon Subjektet Politike sipas numrit të deputeteve të certifikuar nga rezultati i Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës. Mjetet buxhetore të vlerësuara për këtë kategori janë në shumë prej 5,641,020.00 euro.

### 3. Vlerësimi i Buxhetit për vitin 2027

Vlerësimet e buxhetit për vitin 2027 janë me të ulëta se në vitin paraprak sepse planifikimet kryesisht kanë të bëjnë me shpenzimet operacionale, për përkrahje dhe avancim të proceseve zgjedhore si tërësi si dhe buxheti për mbështetje të partive politike.

Buxheti i vlerësuar për tri programet është në vlerë prej 7,913,791.88 euro nga i cili për paga dhe mëditje 1,382,618.88 euro, mallra dhe shërbime 644,863.00 euro, shpenzime komunale 16,600.00 dhe subvencione e transfere 5,869,710.00 euro.

#### 3.1 Vlerësimi i Buxhetit në Programin e Sekretariatit për vitin 2027

Në Sekretariat Buxheti i planifikuar për vitin 2027 është 2,029,081.88 euro nga të cilat në paga dhe mëditje janë planifikuar 1,382,618.88 euro për 108 zyrtarë. Në mallra dhe shërbime 629,863.00 euro, në shpenzime komunale 16,600.00 euro.

#### 3.2 Vlerësimi i Buxhetit në Programin e Zgjedhjeve për vitin 2027

Në programin e Zgjedhjeve, në vitin 2027 i cili vlerësohet si vit jo zgjedhor, planifikohet buxheti të arrij vlerën prej 15,000.00 euro, ky buxhet është i planifikuar në kategorinë e ekonomike mallra dhe shërbim për furnizim me lidhëse për kutitë e votimit.

#### 3.3 Vlerësimi i Buxhetit në Programin për Mbështetje Demokratike për vitin 2027

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në Ligjin Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058, Ligjin Nr. 04/L-122 dhe LIGJI NR. 08/L-122 dhe bazuar me Ligjin për Ndarjet Buxhetore vjetore. KQZ, Subvencionon Subjektet Politike sipas numrit të deputeteve të certifikuar nga rezultati i Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës. Mjetet buxhetore të vlerësuara për këtë kategori janë në shumë prej 5,869,710.00 euro.



**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 67, nenin 68, nenin 69 nenin 70 nenin 71 nenin 72 dhe nenin 73 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 5 paragrafi 1 të Rregullores Zgjedhore Nr.02/2024 Emërimi, Përbërja dhe Funksionimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 14.10.2024, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për emërimin e anëtarit të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve(KKZ) në Komunën e Obiliqit**

- I. Z. Stevan Radosavljevic, emërohet anëtar i KKZ-së në komunën e Obiliqit, nga subjekti politik GISPO për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen më 9 shkurt 2025.
- II. Mandati i anëtarit të KKZ-së, do të fillojë nga data e emërimit sipas këtij vendimi dhe do të përfundojë pesëmbëdhjetë (15) ditë pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, përveç nëse mandati i KKZ-së ndërpritet para përfundimit të afatit ose zgjatet me vendim të KQZ-së.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 14.10.2024







**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin me 59, 63 dhe 64 dhe 113 të Ligjit Nr.08/L-228 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 14.10.2024, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për Miratimin e Kërkesës për Ridestnim të Mjeteve**

- I. Miratohet e kërkesa e Sekretariatet të KQZ-së Nr.06/A-1750-2024, për ridestininim e mjeteve nga Kodi i Projektit Nr.19435 "Projekti për teknologji të numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit dhe Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve" në projektin "Blerja e Veturave Zyrtare për programin e Zgjedhjeve" (142).
- II. Vlera e aprovuar për ridestnim është 94,000.00€
- III. Kërkesa si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi
- IV. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Prishtinë, 14.10.2024

**Kreshnik RADONIQI**  
Kryesues i KQZ  
Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Prishtinë  
Prishtina  
CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA - AJKQZ



**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

Data/Datum:	14.10.2024
Për/Za:	Z. Kreshnik Radoniqi - Kryesues i KQZ
Përmes/Preko:	Z. Besnik Buzhala - U.D. Drejtor i Sekretariatit të KQZ
Nga/Od:	Znj. Adelina Shala Daku - U.D. Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa / ZKF
Kopje/Kopija:	Arkivës
Lënda/Predmet:	Kërkesë për ridestinim të mjeteve.

I nderuar z. Radoniqi,

Duke pasur parasysh që viti 2024 dhe 2025 janë vite zgjedhore me aktivitete të shtuara operacionale, duke ditur gjendjen teknike të veturave zyrtare në përdorim dhe duke u bazuar në mbetje të mjeteve të lira nga burimet e brendshme buxhetore, kërkojmë nga KQZ aprovimin e kërkesë për ridestinim të mjeteve buxhetore. Kërkesa ka të bëjë me bartjen e mjeteve të mbetura nga projekti me Nr.19345 "Projekti për teknologji të numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit dhe Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve" në projektin, blerja e Veturave Zyrtare për programin e zgjedhjeve (142). Kërkesa për bartje është në vlerë prej 94,000.00 €

Pasi që blerja e veturave është shumë e nevojshme dhe mundësit për blerjen e tyre janë krijuar nga kursimet nga ekzekutimi i projektit për pajisjen e QKNR, presim që kërkesa të shqyrtohet dhe aprovohet nga KQZ.

Me respekt!